STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 19 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON GRANTIN PREJ 8.2 MILIONE DOLLARE PER 'PROJEKTIN SHPRESA' (PROJECT HOPE) PER TE SIGURUAR KESHILLIM TE KRIZES NE ZONAT E GODITURA ME RENDE NGA URAGANI SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot një grant prej 8.2 milionë dollarë nga FEMA për të siguruar një Program të Ndihmës për Këshillimin e Krizës dhe Trainimin të quajtur 'Projekti Shpresa' për banorët e Nju Jorkut në zonat e goditura më rëndë të Uraganit Sendi (Sandy). Zyra e Shëndetit Mendor (OMH) e Shtetit bëri kërkesë për grantin, i cli do të sigurojë takime, këshillime të krizës dhe shërbime edukative për individët në Qytetin e Nju Jorkut, Long Ajlënd (Long Island) dhe Luginën e Hadsonit të Poshtëm (Lower Hudson Valley). Ndërsa shteti vazhdon të rimëkëmbet nga stuhia, programi do të marë fonde të tjera për t'u zgjeruar.

Projekti Shpresa administrohet nëpërmjet një partneriteti mes agjencive federale ndërmjet FEMA-s dhe Administratës së Shërbimeve për Abuzimin e Substancave dhe Shëndetit Mendor (SAMHSA). Programi do të jetë në bashkëpunim ndërmjet qeverisë së shtetit dhe pushtetit vendor. Ai pritet të punësojë pothuajse 1,000 këshillues të trainuar të krizës anembanë rajoneve të prekura për të ndihmuar individët e traumatizuar që të kuptojnë gjendjet e tyre, të rifitojë një ndjenjë të kontrollit, të identifikojnë dhe të shprehin emocionet, t'i përshtaten katastrofës, të administrojnë stresin dhe të ndërmarrin veprime me përdorimin e strategjive të përballimit dhe burimeve të komunitetit. Këta këshillues të krizave do t'u bashkohen pothuajse 100 anëtarëve të personelit të OMH Shëndeti Mendor gjatë Katastrofës që tashmë funksionojnë në Qendrat e Rimëkëmbjes nga Katastrofa anembanë shtetit.

Banorët e Shtetit të Nju Jorkut që përjetojnë vuajtje emocionale si rezultat i Uraganit Sendi (Sandy) mund të përdorin këshillimin falas, konfidencial të krizës gjatë 24 orëve gjatë 7 ditëve të javës duke telefonuar LifeNet në 800-543-3638.

"Uragani Sendi (Sandy) solli shkatërrim në ndërtesat dhe rrugët tona – por pasoja nuk ishte vetëm fizike," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo)." Stuhia bëri lëmsh jetën e mijëra banorëve të Nju Jorkut, duke shkatuar dëm që ishte gjithashtu emocional dhe mendor. Projekti Shpresa do të sigurojë ndihmë të shëndetit mendor për banorët e Nju Jorkut në zonat e goditura më rëndë të shtetit dhe inkurajoj ata që mund të jenë duke përjetuar trauma ose thjesht kanë nevojë të bisedojnë me dikë që të telefonojnë për ndihmë. Falënderoj qeverinë federale për ndihmën e tyre."

Projekti Shpresa kërkon të ndihmojë viktimat e Urganit Sendi (Sandy) të kuptojnë se, në shumicën e rasteve, reagimet emocionale të tyre janë normale. Këshilluesit e krizës do të përdorin praktikat e vërtetuara të Ndihmës së Parë Psikologjike, e cila përdor kontaktin mbështetur mbi marrëdhënien për të siguruar mjedise të sigurta dhe të rehatshme për viktimat që të rimëkëmben dhe të marrin informacion, ndihmë dhe referime. Projekti Shpresa synon të ndihmojë mijëra banorë të Nju Jorkut që të kthehen në nivelet e tyre të funksionimit dhe të kujdesit mendor përpara stuhisë.

Të rriturit me vuajtje të vazhdueshme nga një traumë mund të shfaqin shenja irritimi, përqëndrim të keq, gjendje shpirtërore të keqe e mungesë shprese, izolim, shkurajim dhe pasiguri për të ardhmen, brengosje të vazhdueshme për humbjet e tyre, makthe dhe imazhe të së kaluarës, probleme shëndetësore të reja ose në përkeqësim dhe abuzim të alkoolit, duhanit dhe drogës. Fëmijët, veçanërisht ata të ndarë nga familje e tyre, që humbën familjen ose miqtë, ose që u desh të largohen ose rivendosen mund të krijojë reagime të vazhdueshme traumatike dhe të veprojnë si më të vegjël sesa mosha e tyre, të mos shkojnë mire në shkollë, të jenë të izoluar, të përfshihen në sjellje të rrezikshme dhe madje të kenë problem me ligjin.

Nëse ju ose dikush që njihni është duke përjetuar ndonjë prej shenjave të mësipërme të traumës nga Urgani Sendi (Sandy), ju lutemi inkurajojini ata që të marrin ndihmë menjëherë. Sa më shpejt që të marrin ndihmën që ju nevojitet, aq më shpejt mund të fillojnë të rimëkëmben dhe të rindërtojnë jetën e tyre.

Kristin M. Udlok, Komisionere e Përkohëshme e Zyrës së Shëndetit Mendor të Shtetit të Nju Jorkut, tha “Zyra e Shëndetit Mendor e Shtetit të Nju Jorkut ka një histori krenare të sigurimit të rehatisë dhe shërimit të plagëve emocionale të banorëve të Nju Jorkut. Pavarësisht nëse reagojmë ndaj pasojave të sulmeve të 11 shtatorit ose katastrofave natyrore, do të jemi atje. Dhënia e ndihmës për ata që humbën shtëpitë e tyre, mjetet e jetesës ose komunitetet dhe me rëndësi të ndihmojmë reaguesit tanë të parë kurajozë që të përballojnë shkatërrimin që kanë përjetuar.”

Majkëll Bërn, Punonjësi i Bashkërendimit Federal në Administratën Federale të Administrimit të Emergjecave, tha, “E vlerësojmë pasojën që katastrofat mund të kenë tek të mbijetuarit dhe grante si këto ofrojnë mundësi të vlefshme për shtetin dhe komunitetet vendase që të ndihmojnë banorët e tyre që të përballojnë pasojat.”

Dr. Tomas Farli, Komisioneri i Departamentit të Shëndetit dhe Higjenës Mendore të Qytetit të Nju Jorkut, tha, "Projekti Shpresa do të sigurojë ndihma jetësore për të ndihmuar që banorët e Nju Jorkut të përballojnë këto përvoja traumatike dhe të rindërtojnë jetën e tyre. Departamenti i Shëndetit dhe Higjenës Mendore të Qytetit të Nju Jorkut është krenar të jetë partner i kolegëve tanë të Shtetit në këtë përpjekje të rëndësishme."

Ed Mangano, Ekzekutiv i Qarkut Naso (Nassau), tha, "”hkatërrimi i Uraganit Sendi (Sandy) do të ndjehet nga shumë banorë mjaft kohë pasi mbeturinat të jenë pastruar dhe energjia të jetë rikthyer në lagjet tona. Ky program do të jetë i disponueshëm për ata që mund të kenë nevojë për ndihmë në trajtimin e stresit dhe traumës të Uraganit Sendi (Sandy)."

Albanian

Stiv Belloni, Ekzekutiv i Qarkut Safold (Suffolk), tha, “Përveç shkatërrimit të përgjithshëm të shtëpive dhe bizneseve, një katastrofë e shkallës së Sendit (Sandy) lë shumë të mbijetuar me plagë emocionale dërrmuese. Sigurimi i këshillimit të specializuar të krizës dhe të rehatimit për shumë fëmijë dhe familje të traumatizuara që po përpiqen të bashkojnë jetën e tyre përsëri është vendimtar në shërimin afat-gjatë të komunitetit tonë. E vlerësoj udhëheqjen e Guvernatorit Kuomo (Cuomo) në këtë fushë të ndjeshme, si dhe udhëheqjen e tij përmes kësaj veprimtarie të jashtëzakonshme.”

Robert P. Astorino, Ekzekutiv i Qarkut Uestçester, tha, “Kaq shume prej banorëve tanë janë shkatërruar nga stuhia. Kjo shkon përtej dëmit fizik tek shtëpitë dhe bizneset. Projekti Shpresa do të na ndihmojë ne dhe partnerët e agjencisë tonë që të ndihmojnë ata që kanë nevojë për mbështetje emocionale.”

C. Skot Vanderhof, Ekzekutiv i Qarkut Roklënd (Rockland), tha, Shumë banorë të Qarkut Roklënd (Rockland) kanë njoftuar simptoma të çrregullimit akut të stresit edhe pse disa mund të mos kenë përjetuar drejtpërdrejt pasojat e Sendit (Sandy). Fatmirësisht, banorët e Roklëndit janë mjaft të forte dhe për shumë nga këta njerëz simptomat do të fillojnë të humbasin intensitetin vetë me kalimin e kohës, përsa kohë që kanë një sistem të shëndoshë të mbështetjes që u lejon të flasin për atë që ndodhi dhe sesi ndjehen në lidhje me të dhe të bëjnë më të mirën për t’u kthyer sa më pranë rutinës normale që mund të arrijnë në këto rrethana. Kjo është se pse jemi veçanërisht mirënjohës ndaj Guvernatorit Kuomo (Cuomo) për ndihmën e vazhdueshme personale dhe udhëheqjen e tij gjatë kësaj katastrofe dhe për sigurimin e financimit të nevojshëm për Këshilluesit e Krizave dhe shërbimeve që kanë lidhje për ata që janë prekur nga super stuhia.”

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418